



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 280/2 prot.

Tiranë, më 19.05.2022

**VENDIM**

**Nr.72, datë 19.05.2022**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 167, DATË 30.12.2021**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Zbatimin e Vendimeve Paralajmëruese, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 167, datë 30.12.2021, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, së disa procedurave të rekrutimit në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil, për mospërmbyllje të kërkesave të veçanta për nëpunëset \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe konkurrimit në kushtet e konfliktit të interesave, për nëpunësen \*\*\*\*\*”.

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të paraqitur nga shtetasi \*\*\*\*\* , regjistruar me nr. 1044 prot., datë 23.11.2021, pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil janë ngritur disa pretendime për rekrutime të kryera në kundërshtim me ligjin, në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil, në pozicionet e punës ku aktualisht janë të punësuar nëpunëset \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ duke kërkuar nga institucioni i Autoritetit të Aviacionit Civil të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këto raste.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr.167, datë 30.12.2021, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, së disa procedurave të rekrutimit në

*institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil, për mospërbushje të kërkesave të veçanta për nëpunëset \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe konkurrimit në kushtet e konfliktit të interesave, për nëpunësen \*\*\*\*\*”.*

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Autoriteti i Aviacionit Civil ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.167, datë 30.12.2021, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastet në fjalë paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse DAP, që në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore të institucionit Autoriteti i Aviacionit Civil, në kuadër të hetimit administrativ të nisur, të verifikojnë vërtetësinë e denoncimit të bërë për ekzistencën e lidhjes së interesave private, marrëdhënie bashkëjetese midis nëpunësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , duke administruar, ndër të tjera edhe deklaratën e punonjësve në fjalë, në lidhje me këtë fakt, si dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit duhet të vijojë me analizën e detyrave që kryen secili nga punonjësit, për të verifikuar nëse kjo lidhje mund të bëhet shkak për mundësinë e lindjes së konfliktit të interesit në të ardhmen.

Konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 629/1 prot., datë 15.02.2022, *“Kthim përgjigje”*, dërguar Autoritetit të Aviacionit Civil dhe për dijeni Komisionerit, ka kërkuar vënien në dispozicion të deklarimeve të nëpunësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , për interesat e tyre private dhe në rast se nuk është bërë deklarimi, sikurse parashikohet në nenin 7 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të instersave në ushtrimin e funksioneve publike”*.

Në vijim, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 629/3 prot., datë 24.03.2022, drejtuar Autoritetit të Aviacionit Civil ka kërkuar nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit të AAC-së argumentimin dhe analizimin e detajuar të detyrave funksionale që kryejnë nëpunësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , sipas përshkrimeve të punës të miratuara dhe përcaktimin nëse kjo lidhje përbën apo jo konflikt interesi.

Me shkresën nr.591/2 prot., datë 11.04.2022, *“Kthim përgjigje”*, dërguar Departamentit të Administratës Publike dhe për dijeni Komisionerit, Autoriteti i Aviacionit Civil, sipas analizës së bërë dhe bazuar në përshkrimet e punës për këto dy pozicione është shprehur se ato janë të shkëputur nga njëri-tjetri dhe nuk përbëjnë konflikt interesi.

Sa më sipër, vërej se, nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil janë zbatuar rekomandimet e lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 167, datë 30.12.2021, të Komisionerit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 167, datë 30.12.21, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, së disa procedurave të rekrutimit në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil, për mospërbushje të kërkesave të veçanta për nëpunëset \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe konkurrimit në kushtet e konfliktit të interesave, për nëpunësen \*\*\*\*\*”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil, duke zbatuar rekomandimet e vendimit nr. 167, datë 30.12.2021.
3. Për këtë vendim të njoftohet, Departamenti i Administratës Publike dhe institucioni Autoriteti i Aviacionit Civil.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**